



Prishtinë: 28.01.2019  
Kodi i ZRRE-së: V\_1104\_2019

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

### Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_1889\_11\_18**;
- Ankesa e KESCO-së e datës **28.12.2018**.

në seancën e mbajtur më datë **28.01.2019**, nxori këtë:

### V E N D I M

- I REFUZOHET** ankesa e KESCO-së ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin S.H , nga Prishtina, me shifër të konsumatorit: DPR - 204709, si e pa bazuar.
- II MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. **ZRRE/DMK\_V\_1889\_11\_18** i datës 20.11.2018.

### A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 06.11.2018 ka pranuar ankesën e parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së, i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE si vendim i shkalës së parë për këto shkaqe: Përfaqësuesi i KESCO-së, në ankesë ka theksuar se gjendja e shpenzimit të energjisë elektrike e njehsorit elektrik nr.16067256 ka qenë e verifikuar nga KEDS, si dhe faturimi i bërë me datë 23.11.2016 është i saktë dhe real. Në ankesë është theksuar se edhe DMK/ZRRE e ka kosntatuar se duhet të bëhet rikalkulimi i faturave nga data 11/2015 – 10/2016 pasi faturimi është në grupin tarifor 4/02 dhe se duhet të bëhet si 7/02. KESCO ka theksuar se korrigjimi është bërë sipas shpenzimit mujor sipas grupit tarifor 7/02 dhe jo 4/02, dhe se nuk pajtohet me DMK/ZRRE kur ka bërë shpërndarjen e shpenzimit pasi KESCO po dëmtohet. KESC po ashtu ka theksuar se DMK/ZRRE ka theksuar se konsumatori ka ofruar kontratën e qerasë së datës 01.07.2015 por nuk ka marrë vendim për korrigjim të asaj periudhe. KESCO në ankesën e tyre kanë theksuar se kërkojnë nga Bordi i ZRRE-së që pezullojnë vendimin e DMK-së ZRRE/DMK\_V\_1889\_11\_18 i datës 20.11.2018 për konsumatorin S. H. me shifër DPR - 204709.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 28.01.2019 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të KESCO-s gjendja e shpenzimit të energjisë elektrike e njehsorit elektrik nr.4851384 ka qenë e verifikuar nga KEDS, Bordi i ZRRE-së thekson se punëtorët e autorizuar



të KEDS-it për inspektimin e pikave matëse me datë 17.03.2016 kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit dhe gjatë inspektimit kanë evidentuar gjendjen e shpenzimeve të regjistruara në njehsorin elektrik nr.16067256 prej TL=008033 kWh dhe TU=002417 kWh, si dhe kanë theksuar se shifra DPR – 204709 është duke u faturuar si konsumatori i grupit tarifor 5 (4/02). Gjithashtu Bordi i ZRRE-së ka vërejtur se me datë 22.09.2016 punëtorët e autorizuar të KEDS-it për inspektimin e pikës matëse prapë kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit dhe gjatë inspektimit kanë evidentuar gjendjen e shpenzimeve në njehsorin elektrik nr.16067256 prej TL=009321 kWh dhe TU=002619 kWh, të dhënat teknike të pikës matëse përfshi edhe fuqinë e instaluar ku P=5 kW, si dhe kanë evidentuar që konsumatorit duhet t'i ndërrohet grupi tarifor nga shtëpiak 5 (4/02) në komercial 4 (7/02). Bordi i ZRRE thekson se as në vendimin e organit të shkallës së parë (DMK/ZRRE) nuk është mohuar se energjia nuk është shpenzuar, por faturimi nuk ka qenë në rregull. Pra, Bordi i ZRRE thekson se punëtorët e autorizuar të KEDS-it nuk kanë vepruar konform Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji dhe Procedurës për Leximin dhe Faturimin e konsumatorëve tarifor, pasi që për çdo muaj kanë obligim për të bërë leximin dhe faturimin e pikës matëse dhe është dashur të vërehet më herët ky gabim. Megjithatë Brodi i ZRRE thekson se as në vendimin e organit të shkallës së parë (DMK/ZRRE) nuk është mohuar se energjia nuk është shpenzuar, por që faturimi nuk ka qenë në rregull, e së ky konstatim është plotësisht i saktë.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të KESCO-s se korrigjimi i KESCO-s bërë konsumatorit është bërë sipas shpenzimit mujor sipas grupit tarifor 7/02 dhe jo 4/02, dhe se nuk pajtohet me DMK/ZRRE kur ka bërë shpërndarjen e shpenzimit pasi KESCO po dëmtohet, Bordi i ZRRE thekson se sipas shkresave të lëndës konsumatori nga fillimi deri në periudhën shtator 2016 është faturuar si konsumator shtëpiak tarifor 5 (4/02), kurse nga kjo periudhe e tutje si konsumator komercial 4 (7/02). Bordi i ZRRE gjithashtu ka shqyrtuar edhe korrigjimet nr. 87788DPR-204709 dhe 87789DPR-204709 të datës 23.11.2016 e bëra nga KESCO dhe konstaton se me rastin e korrigjimit të faturës për shërbime (ndërrim i grupit tariforë) - 47€, KESCO ka vepruar drejt, kurse ka gabuar me korrigjimin e kWh të faturuar për periudhën 11/2015 deri në periudhën 10/2016, pasi që për shkak të gabimeve të bëra në lexim dhe faturim gjatë kësaj periudhe të bërë nga KESCO, ZRRE ka kërkuar të bëhet rifaturimi i faturave për periudhën 11/2015 deri në periudhën 10/2016 duke bërë shpërndarjen e kWh dhe se për këtë konsumatori duhet të ngarkohet me korrigjim plotësues në vlerë 253.78€, dhe jo në vlerë 508.34€.

Sa i përket pikës së kundërshtimit se se konsumatori ka ofruar kontratën e qerasë së datës 01.07.2015, por nuk ka marrë vendim për korrigjim të asaj periudhe, Bordi i ZRRE-së thekson se Genc Jaha ne emër të qiramarrësit KDI (Kosova Democratic Institute) ka ofruar kontratën mbi qiranë të lidhur në mes të KDI-së – OJQ, nr. i biznesit 51102258, nr. fiskal 600212790 përfaqësuar nga Ismet Kryeziu me numër personal 1007216261 dhe qiramarrësit S. H. me numër personal L77817YML me të cilën vërtetohet se objekti është marr me qira nga periudha 01.07.2015, pra nga kjo datë sipas kontratës objektin me qera e ka pasur KDI. Gjithashtu Bordi i ZRRE thekson se vet është dashur KESCO që të bëjë një faturim të tillë dhe jo ZRRE, pasi ZRRE nuk lëshon faturat të energjisë elektrike.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 28.01.2019 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

**III.** Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.



- IV.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

**Bordi i ZRRE-së:**

\_\_\_\_\_  
Arsim Janova, u.d. kryesues

\_\_\_\_\_  
Besim Sejfiqaj, anëtar

\_\_\_\_\_  
Selman Hoti, anëtar

\_\_\_\_\_  
Izet Rushiti, anëtar

**Vendimi iu dërgohet:**

- KESCO-së, dhe
- Konsumatorit S. H., dhe
- Arkivit të ZRRE-së.